



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 3039/2 Prot.

Tiranë, më 14.11 2023

VENDIM

Nr. 116 dt. 14.11 2023

“PËR MËNYRËN E KOMPOZIMIT, KRITERET E PËRZGJEDHJES DHE HAPJEN E THIRRJES PËR VETËKANDIDIM TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË ETIKËS PËR KËRKIMIN SHKENCOR, NË UST”

Mbështetur në nenin 36 pika 6, nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, v.k.m-në nr. 57, datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, në Udhëzimin nr.27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”, në nenin 7 pika 4, gërma a, nenin 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 14.11.2023

V E N D O S I :

1. Këshilli i Etikës për Kërkimin Shkencor ka në përbërje të tij:
 - 2 (dy përfaqësues) të Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit
 - nga 1 (një) përfaqësues për secilën njësi kryesore (fakultet).
2. Ata zgjidhen midis anëtarëve të personelit akademik, të vetëkandiduar që kanë së paku gradën shkencore Doktor.
3. Hapjen e thirrjes për vetëkandidim për anëtarë të Këshillit të Etikës për Kërkimin Shkencor nga data 15.11.2023 deri më 20.11.2023).
4. Ky Vendim t’i përcillet për njohje dhe publikim njëjive kryesore si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

